

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DEGA E NOTERISE TIRANE

Nr 582 Rep



Taksa e pulles 200Lek u aplikua

**VERTETIM STATUT dhe AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“PARK AL” SH.P.K**

Sot më datë 18/01/2021 une noterja Ridvana Ruci, me Zyre ne rrugen “Kajo Karafili”, deklaroj se para meje u paraqiten personalisht personat e meposhtem te cilet me kerkuan hartimin dhe nenshkrimin e ketij Statuti dhe Akti Themelimi:

Z. Florida Kolleshi, shtetase Shqiptare, atesia Sazan dhe amesia Fildete, lindur me 30.11.1991, ne Kelcyre dhe me banim ne Tirane, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin me nr. Personal J16130044F, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Z.Riza Arshiaj, shtetas Shqiptar, atesia Qemal dhe amesia Marsela, lindur me 23.10.1999, ne Lепенice dhe me banim ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin me nr. J91023046E.


Z.Ennio Caushaj, shtetas Shqiptar, atesia Novruz dhe amesia Zamira, lindur me 10.04.1993, ne Patos dhe me banim ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin me nr. J30410085J.

Ky Statut është nenshkruar para meje noteres në Tirane më 18/01/2021 në tre ekzemplarë origjinal kete statut dhe akt themelimi te shoqerise **PARK AL** shpk, duke patur fuqi të barabartë ligjore dhe une Noterja e vertetoj kete.

Ortaket e kesaj shoqerie pasi lexuan me vëmendje dokumentat e mësipërme dhe e gjeten konform vullnetit të tyre e nënshkruan para meje rregullisht.

NOTERE

RIDVANA RUÇI



**AKT THEMELIMI
&
STATUT I SHOQËRISË TREGTARE TË SË DREJTËS SHQIPTARE
STATUT I SHOQERISE
« PARK AL» Sh.P.K.**

Sot, me date 27 .12.2020 ne cilesine e ortakeve te shoqerise **PARK AL** shpk ne personat e meposhtem biem dakort per hartimin dhe nenshkrimin e ketij Statuti dhe Akti Themelimi një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K)

Z. Florida Kolleshi, shtetase Shqiptare, atesia Sazan dhe amesia Fildete, lindur me 30.11.1991, ne Kelcyre dhe me banim ne Tirane, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin me nr. Personal J16130044F, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Z.Riza Arshiaj, shtetas Shqiptar, atesia Qemal dhe amesia Marsela, lindur me 23.10.1999, ne Lепенice dhe me banim ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin me nr. J91023046E.

Z.Ennio Caushaj, shtetas Shqiptar, atesia Novruz dhe amesia Zamira, lindur me 10.04.1993, ne Patos dhe me banim ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin me nr. J30410085J.

Ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, te ndryshuar, dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, kemi miratuar kete Statut si vijon:

KAPITULLI I

THEMELIMI – EMRI – FORMA – SELIA - OBJEKTI – KOHEZGJATJA

Neni 1

Themelimi, Emri dhe Forma

Emri dhe emertimi tregtar i Shoqerise eshte **PARK AL SH.P.K.**

Shoqeria **PARK AL SH.P.K.** eshte nje person juridik privat, e themeluar ne baze te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” (me pas referuar si “Ligji Tregtar”) ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar (Sh.P.K.).

Shoqeria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar qe mbahet nga Qendra Kombetare te Biznesit (me pas referuar si “QKB”) ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.

Me fitimin e personalitetit juridik, Shoqeria behet pergjegjese kundrejt paleve te treta, per detyrimet dhe demet qe shkakton gjate veprimtarise se saj.

Ortaket e Shoqerise do te jene pergjegjes kundrejt paleve te treta deri ne shumen e kontributit te derdhur ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

Neni 2

Selia

Shoqeria do ta kete seline e saj ne adresen e meposhtme: Rruga “Ismail Qemali” shkalla 1, kati 10, apartamenti nr.51, Tirane, Shqiperi.

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi kudo brenda Republikës së Shqipërisë.

Neni 3 Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë sa vijon:

Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës: Shërbime të kontabilitetit, konsulences fiskale dhe ligjore. Opinione mbi shkëmbimet dhe mbi emetimet e aksioneve të reja. Shërbime të konsulences në fushën e arsimit të lartë, kërkimit shkencor, inovacionit, transferimit të teknologjise. *Ndertime të objekteve civile dhe industriale, import-eksport të mallrave, konsulence, supervizim, kualitim, tregtim të mallrave të ndryshëm, (elektroshtepiake, teknologjike, ushqimore, kancelari, mallrave industrial etj*

Ne fushën e ndertimeve, parkimeve.

Sidoqoftë, asgjë nuk do të interpretohet këtu si kufizim i mundësisë së shoqërisë për të hyrë në tregje apo aktivitete dhe operacione të tjera tregtare që janë të lidhura me apo në funksion të objektit të mësipërm.

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortave, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe këtë Statut

Sidoqoftë, asgjë nuk do të interpretohet këtu si kufizim i mundësisë së shoqërisë për të hyrë në tregje apo aktivitete dhe operacione të tjera tregtare që janë të lidhura me apo në funksion të objektit të mësipërm.

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortave, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe këtë Statut.

Neni 4 Kohegjatja

Kohegjatja e Shoqërisë është e pakufizuar. Shoqëria mund të prishet në çdo kohë me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortave, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

KAPITULLI II KAPITALI – KUOTAT

Neni 5 Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 Lekë (një qind mijë leke).

Kapitali themeltar përbehet nga 3 (tre) kuote që janë paguar e zotërohen teresisht nga ortakët themelues si vijon:

Z. Florida Kolleshi, zotëruar i 1 (një) kuote, me vlerë nominale 80,000 Lekë, duke përfaqësuar 80% (tetëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar;

Z. Riza Arshiaj, zotëruar i 1 (një) kuote, me vlerë nominale 10,000 Lekë, duke përfaqësuar 10% (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar;

Z. Ennio Caushaj, zotëruar i 1 (një) kuote, me vlerë nominale 10,000 Lekë, duke përfaqësuar 10% (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar;

Ortakët janë përgjegjës kundrejt paleve të treta për humbjet që pëson Shoqëria, deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore.

Neni 6

Kuotat

Te drejtat dhe detyrimet e lidhura

Secili ortak do te kete nje numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij. Pronesia mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve qe do te mbahet ne seline e Shoqerise nen pergjegjesine e Administratoreve ("Regjistri i Ortakeve").

Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposhtem: (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin dhe vleren e kuotes qe zoterohet nga cdo Ortak; (iii) daten e fitimit te pronesis se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaku; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.

Neni 7

Transferimi i Kuotave

- 7.1. Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje ne cdo forme te gjitha apo nje pjese te kuotes se tij nje personi te ndryshem nga Ortaket, secili prej Ortakeve te tjere ka te drejten e parablerjes mbi te gjitha apo nje pjese te kuotes ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar, ne varesi te faktit se sa ortake do te ushtrojne te drejten e parablerjes ne rastin konkret. E drejta e parablerjes ushtrohet vetem ne perputhje me proceduren ne vijim.
- 7.2. Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje te gjitha apo nje pjese te kuotes se tij, ai, perpara se te nenshkruaje marreveshje me persona te ndryshem nga Ortaket, do te njoftoje me shkrim Administratoren per transferimin e planifikuar, duke percaktuar edhe çmimin e transferimit, personin/at te cileve planifikon t'u transferoje kuoten dhe kushtet esenciale qe do te aplikohen per transferimin.
- 7.3. Administratoren, brenda 10 diteve duke filluar nga dita kur eshte njoftuar nga Ortaku per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te informojne me shkrim Ortaket e tjere.
- 7.4. Secili prej Ortakeve qe ka te drejta parablerjeje, brenda 1 (nje) muaji nga njoftimi prej Administratoreve per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te njoftoje me shkrim Administratoren nese ka qellim te ushtroje te drejten e tij te parablerjes.
- 7.5. Administratoren brenda 10 diteve nga marrja e ketij njoftimi do te njoftojne me shkrim Ortakun qe deshiron te transferoje kuotat e tij.
- 7.6. Nese me shume se nje Ortake ushtrojne te drejtat e parablerjes se kuotes, ata do te blejne kuoten ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar.
- 7.7. Nese asnje njoftim nuk eshte dhene nga ndonje Ortak si me siper, Ortaku qe ka per qellim te transferoje kuoten e tij do te jete i lire t'ia transferoje kete kuote personit/ave te percaktuar prej tij.
- 7.8. Nese vetem nje Ortak ka dhene njoftim per qellimin e tij per te ushtruar te drejten e parablerjes, ky Ortak do te kete te drejte te bleje kuoten objekt transferimi brenda 10 diteve nga data e mbarimit te afatit 1 (nje) mujor te percaktuar me siper.
- 7.9. Çdo transferim i kuotave qe nuk kryhet ne perputhje me parashikimet e ketij neni eshte i pavlefshem dhe pa efekte per Shoqerine.

Neni 8

Zmadhimi i Kapitalit

4

Kapitali themeltar mund te zmadhohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, nepermjet emetimit te kuotave te reja ose rritjes se vleres nominale te atyre ekzistuese ose ne çdo forme tjeter te parashikuar nga Ligji. Per cdo zmadhim kapitali te Shoqerise nepermjet emetimit te kuotave te reja, Ortaket do te kene te drejten e parablerjes per nenshkrimin e ketyre kuotave te reja te emetuara. Nese me shume se 1 (nje) Ortak ushtrojne te drejtat e tyre te parablerjes brenda 20 (njetzet) diteve, atehere ata do t'i blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar. Çdo kuote e re qe nuk eshte blere nga Ortaket gjate ketij procesi, i ofrohet çdo pale te trete.

Kuotat e reja qe do te shlyhen si me para ne dore, ashtu edhe ne natyre, do te paguhen ne perputhje me Vendimin perkates per zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin per Shoqerite Tregtare.

Neni 9

Zvogelimi i Kapitalit

Kapitali mund te zvogelohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare.

KAPITULLI III

ORGANET E SHOQERISE

Neni 10

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte i Shoqerise, i cili, veç kompetencave te tjera sipas Ligjit per Shoqerite Tregtare apo ketij Statuti, merr vendime per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise:

- a. percaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshime te Statutit;
- c. emerimi i Administratoreve;
- d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
- f. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve te ecurise se veprimtarise se Shoqerise;
- g. shperndarjen e fitimeve vjetore;
- i. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise;
- j. pjesetimin dhe anulimin e kuotave;
- k. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime;
- l. riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- m. miratimin e rregullave te zbatueshme procedurale te mbledhjeve te saj;
- n. çeshtje te tjera sipas parashikimeve te bera prej ketij Statuti.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme mund te dergohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqerise me poste te regjistruar. Njoftimi do te konsiderohet se i eshte dorezuar Shoqerise me kalimin e dites se 10-te pas dergimit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te percaktoje qarte emrin e Shoqerise, seline, daten, kohen dhe vendin e mbledhjes, nje pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaket per pjesemarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyren e marrjes se dokumenteve dhe

5

projekt-vendimeve qe duhet tu vihen ne dispozicion te gjithe Ortakeve, po ashtu edhe rendin e dites, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve te pakten 14 (katërmbëdhjetë) dite para mbledhjes. Rendi i dites i njoftuar si me sipër duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve duhet të vendosë për ndryshime të Statutit, teksti përkatës duhet të njoftohet së bashku me rendin e dites.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve do të thirret nga Administratorët dhe, kur është e zbatueshme, nga Ortaket.

Një Ortak mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakeve nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë i ndryshëm nga Administratorët, duke paraqitur dokumentin përkatës autorizues. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblese së Përgjithshme të Ortakeve, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmeria e vendimeve që përcaktojnë detyrime shtese ose kufizojnë / zvogelojnë të drejtat që u janë njohur ortakëve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtëzohet nga miratimi i Ortakut të interesuar / përkatës.

Të gjitha vendimet e Asamblese duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e një kopjeje të tij.

Neni 11

Organi Administrues / Administratorët

Organi Administrues përbehet nga 1 (një) Administrator që emërohet e shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve. Kohezagjatja e mandatit të Administratorit është 5 (pese) vjet, me të drejtë ri-emërimi.

Personi i mëposhtëm caktohen si Administrator i parë i shoqërisë me mandat 5 vjeçar:

Z.Riza Arshiaj, shtetas Shqiptar, atesia Qemal dhe amesia Marsela, lindur me 23.10.1999, në Lepenice dhe me banim në Tiranë, madhor dhe me zotesi të plote për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr. J91023046E

Administratori perfaqeson Shoqerine sipas parashikimeve te Statutit.

Administratori do te:

- (i) administroje veprimtarine tregtare te Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve;
- (ii) perfaqesoje Shoqerine;
- (iii) kujdeset per mbajtjen e rregullt te librave dhe dokumenteve kontabel;
- (iv) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, te cilat ia paraqet Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per miratim, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;
- (v) krijojte nje sistem njoftimi te pershtatshem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
- (vi) kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit Tregtar apo te ligjeve te tjera te zbatueshme;
- (vii) raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve mbi zbatimin e politikave tregtare si dhe per perfundimin e transaksioneve me rendesi te veçante per performancen e Shoqerise;
- (viii) kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin Tregtar dhe ne kete Statut;
- (ix) therrase mbledhjen e Asamblese se Ortakeve sa here qe kerkohet sipas Ligjit apo ketij Statuti.

Administratori mund te autorizojte persona te tjere per te vepruar ne emri dhe per llogarine e tij, duke specifikuar / percaktuar kategoria e akteve dhe veprimeve qe perfaqesuesi mund te kryeje. Veç kufizimeve ligjore, nuk vendosen kufizime te kompetencave te administrimit.

Neni 12

Kontrolli i Shoqerise

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te emeroje nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar per kontrollin e llogarive te Shoqerise.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, FITIMET DHE REZERVAT LIGJORE

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhete) muajsh e cila fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

Ne menyre perjashtimore, viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

Neni 14

Rezerva Ligjore

Shoqeria do te kaloje ne fondin rezerve te detyrueshem te pakten 5% (pese perqind) te fitimit vjetor neto derisa kjo rezerve te arrije vleren e barabarte me 10% (dhjete per qind) te kapitalit themeltar.

Neni 15

Dividendet

Pas miratimi te bilancit vletor dhe percaktimit te shumes qe do te ndahet, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton shumen e fitimeve qe do t'i shperndahet secilit prej Ortakeve si dividend, ne perpjestim me pjesen perkatese ne kapitalin themeltar.

KAPITULLI V
PRISHJA - LIKUIDIMI



Neni 16

Prishja e Shoqerise

Shoqeria priset (i) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve; ose (ii) ne rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqeria nuk ka kryer veprimtari per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne QKB; ose (iv) me vendim gjykate; ose (v) per arsye te tjera te parashikuara ne ligj.

Neni 17

Likuidimi

Me perjashtim te rastit te fillimit te nje procedure falimentimi, prishja e Shoqerise shoqerohet me fillimin e procedures se likuidimit.

Neni 18

Dispozita Perfundimtare

Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar.


Konfliktet ne lidhje me kete Statut do te zgjidhen nga gjykata e rrethit gjyqesor ne territorin e se ciles Shoqeria ka seline e saj.


Me qellim shmangien e cdo paqartesis, ndryshimi i ortakeve dhe/ose Administratorit, dhe/ose cdo funksionari tjetere nuk do te konsiderohen si ndryshime te ketij Statuti.

Për ndjekjen e të gjithë procedurave në lidhje me regjistrimin fillestar të Shoqërisë dhe akteve përkatëse në Regjistrin Tregtar (QKB) ne autorizojme nepermjet ketij akti **Z.Riza Arshiaj**, shtetas Shqiptar, atesia Qemal dhe amesia Marsela, lindur me 23.10.1999, ne Lepenice dhe me banim ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin me nr. J91023046E, i cili mund të paraqitet e veprojë me të drejta e kompetenca të plota për nënshkrimin dhe dorëzimin e çdo aplikimi, kërkesë dhe/ose dokumenti që konsiderohet se duhet paraqitur pranë Regjistrin Tregtar për kompletimin e regjistrimit.

Ky Statut nenshkruhet rregullisht ne 3 (tre) origjinale ne gjuhen Shqipe.

ORTAKET THEMELEUES

1. Riza Arshiaj 

2. Ennio Caushej 

3. Florida Kolleshi 